



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-32145/24 datë:18.12.2024



Npi – 01/433 datë: 23.12.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 23.12.2024, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -XII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 23.12.2024 (e hënë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, dhe z.Arton Demiri. Në mbledhje ka munguar znj.Shkurte Behluli e cila ka dhënë dorëheqje. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Përfaqësuesit e UNMIK-ut z.Xhavit Fejza dhe Florent Salihu. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 27.11.2024,
2. Propozi-Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit Npi- 01-291 dt. 27.09.2022 për KKSB,
3. Raporti i përgjithshëm i 6-mujorit të II të i Punës së ekzekutivit në Komunën e Shtimes,
4. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së KPK-së dhe Orarit të mbledhjeve për vitin 2025,
5. Diskutim për 15 Shkurtin dita nacionale e Komunitetit Ashkali,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës, propozoj që pikën e 4 ta shtyjme për mbledhjen e radhës, sepse materiali nuk është gati.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës, si vijon:**

- 1.Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 27.11.2024,
- 2.Propozi-Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit Npi- 01-291 dt. 27.09.2022 për KKSB,
- 3.Raporti i përgjithshëm i 6-mujorit të II të i Punës së ekzekutivit në Komunën e Shtimes,
- 4.Diskutim për 15 Shkurtin dita nacionale e Komunitetit Ashkali,
- 5.Të ndryshme.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 27.11.2024

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 27.11.2024.**

Pika 2

Propozi-Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit Npi- 01-291 dt. 27.09.2022 për KKSBB

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Siç dihet në KKSBB-ë duhet të behen disa ndryshime dhe të plotësohet me disa anëtarë e një prej tyre është edhe një anëtarë nga Komuniteti, mirëpo duhet ti kemi emrat.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Po i kemi dy emra Muhamet Mehmeti dhe Arton Demiri. Kështu që Muhameti sa e di është pranuar në Zyrën Komonale për Komunitete dhe Kthim, dhe e shfrytëzoj rastin që ta uroj.

z.Besnik Seferi: Meqenëse qenka pranuar Muhameti në ZKKK-ë i uroj punësim, por ndoshta në vendim-marrje nuk duhet të merr pjesë, sepse mund të ketë konflikt interesi. Sa i përket Zyrës për Komunitete, unë besoj se Muhameti e Meriton, dhe unë besoj se do ta funksionalizojë Zyrën për Komunitete. Propozimet për zëvendësim nga Komiteti do të vijnë në Kuvend për miratim.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Jo Muhameti, ende nuk e ka nënshkruar kontratën dhe tani për tani nuk ka konflikt interesi, ndërsa procedurën do ta rregullojmë më vonë me sekretarinë. Në vazhdim Konstatoj Kuorumin, në mbledhje prezent janë 5 anëtarë të Komitetit.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit të Komunës së Shtimes, miratimin e Vendimit për Plotësim-Ndryshimin e vendimit Npi- 01-291 dt. 27.09.2022 për KKSBB-në, duke futur si anëtarë edhe z.Muhamet Mehmetin dhe z.Arton Demiri.**

Pika 3

Raporti i përgjithshëm i 6-mujorit të II të i Punës së ekzekutivit në Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi: Lidhur me raportin edhe unë jam i interesuar për me pa për sa i përket Zyrës për Komunitete, por sa të na e dërgon Sekretaria.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Meqenëse e kemi miratuar rendin e ditës, tani nuk mundemi me e shty për mbledhjen tjetër, por ndoshta në mbledhjen tjetër mundemi me e diskutuar te pika të ndryshme. Kështu që tani po e kalojmë këtë pikë.

Pika 4

Diskutim për 15 Shkurtin dita nacionale e Komunitetit Ashkali

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Ne realisht për këtë pikë kemi pritur që në mbledhje me na ardhur drejtoresha për me na e prezantuar. Drejtoresha nuk e ka marrë parasysh Rekomandimin tonë në vitin e kaluar për manifestimin e vitit 2024. Komuniteti Ashkali është i dyti pas Shqiptarëve, dhe këte duhet me marrë parasysh edhe Komuna, dhe me marrë përsipër organizimin e kësaj dite 15 Shkurtin, dita nacionale e komunitetit Ashkali.

z.Besnik Seferi: Pajtoj me ato që i tha Kryesuesi, dhe kisha dashur që drejtoresha të jetë prezente në mbledhje, dhe mos të merr vendime ad-hoc, por të jetë bashkëpunuese me Komitetin për Komunitete. Ajo është zotuar që do të angazhohet për këto aktivitete të 15 Shkurtit, dita e Ashkalive, dhe mos të krijoj ndasi.

z.Muhamet Mehmeti: Përshëndetje. Sa i përket 15 Shkurtit, sipas planit që e kam pa në Zyrën për Komunitete, është një plan që organizimi duhet të bëhet nga OJQ-të. Unë besoj se problemi ka me qenë i njejtë edhe në këtë vit. Unë besoj se sivjet ka me shku më ndryshe se i përket shqyrtimit të kërkesave. Atëherë kërkesat kanë shkuar përmes këshillit organizativ, unë nuk dëshiroj që kështu me shkuar edhe në vitin 2025, mirëpo sigurisht që duhet me shkuar edhe planet e OJQ-ve se qka kanë planifikuar për 15 Shkurtin.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Unë propozoj që ditën e premtë me u tubuar ne anëtarët e Komitetit me u takuar me drejtoreshën dhe me biseduar. Nëse nuk keni kohë atëher mundemi vetem dy anëtarë me u takuar, pastaj në muajin Janar e diskutojmë në mbledhje bashkërisht, dhe e shikojmë se çka mundemi me bërë.

Pika 5

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Unë kisha dashur me e diskutuar çështjen e ndarjes së dhuratave për fëmijë, ashtu siq e diskutuam pak në mbledhjen e kaluar. Ndoshta është mirë që ne sot me u takuar pas orës 16:00h para “Eliabit”, dhe të marten me i shpërnda dhuratat, sepse edhe përfundon procesi mësimor. Unë personalisht nuk e di nëse mundem me marrë pjesë, sepse jamë shumë i nxanun për me e përfunduar vitin e Organizatës ku punoj.

z.Muhamet Mehmeti: Ne sot ndoshta mundemi me e përfunduar, edhe pse unë kamë dhënë dorëheqje të këshilli i prindërve në shkoll. Realisht unë nuk e di nëse me këto dhurata ne po krijojmë ndasi në mes nxënësve.

z.Besnik Seferi: Kohën e kemi të shkurtë, kështu që unë mendoj që mundemi veq në Shtime me e përfunduar.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Ju mund të vazhdoni ashtu qysh mendoni se është më mirë. Për këtë vit unë dua të ju falenderoj për bashkëpunim, duke filluar nga Sekretaria me z.Idajet Rexhepin, për një punë shumë të madhe që e ka bërë, pastaj edhe të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete. Ju kërkoj falje, nëse dikush është ndier i ofenduar ose për shkak të ndonjë gabimi të pa qëllimshëm. E falenderoj Komunën për punën dhe shpresoj se rekomandimet në vitin e ardhshëm do të merren më shumë parasysh. I falënderoj organizatat ndërkombëtare si OSBE-në e UNMIK-un që e kanë monitoruar punën tonë.

z.Florent Salihu, përfaqësues nga UNMIK: Përshëndetje. Unë e mora fjalën vetëm për të ju falënderuar për bashkëpunimin. Ne i mbulojmë edhe Komunat tjera, por dua të ju përgëzoj për punën e juaj, organizimin dhe sidomos me pagesën e rregullt që u është bërë anëtarëve të Komitetit për Komunitete, sepse të drejtën me thanë Komunat tjera kanë pasë bukur shumë probleme me pagesën e KPK-së. Ne ua kemi përcjellë metodën e juaj të pagesës Komunave dhe kjo u ka ndihmuar edhe atyre për zgjidhjen e këtijë problemi. Në fund ju uroj festat e fundvitit dhe punë të mbarë në vitin 2025.

z.Muhamet Mehmeti: Edhe unë ju uroj vitin e ri. Meqenëse ky është takimi im i fundit si anëtarë i Komitetit për Komunitete, juve ju uroj punë të mbarë, dhe po kërkoj një bashkëpunim më të mirë, meqenëse, unë do të jem zyrtar i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 10:44h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

